



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Vlerësimi i ecuresisë së raportimeve të veprimtarive publike të institucioneve për periudhën 13 Janar deri më 23 Janar 2023

Në datën 13 Janar 2023, ka filluar zbatimi i detyrimeve për organet publike për të raportuar në KQZ mbi veprimtaritë e tyre publike për periudhën 4 muaj përpara datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve

Sa më sipër ky detyrim përcaktohet/rregullohet nga nenet 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimi nr. 9 datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator.

Sipas përcaktimeve të mësipërme rregullatore institucionet publike raportojnë për veprimtaritë e tyre publike nëpërmjet ndërfaqes përkatëse elektronike në internet aktivitete.kqz.gov.al.

Ndërfaqja e raportimeve përbën elementin kyç, në zbatimin e kuadrit rregullator për raportimin e veprimtarive publike nga Institucionet qendrore dhe vendore. KQZ ka ndërtuar një sistem raportimi me fusha të detyruara, që duhet të plotësohen nga Institucionet që raportojnë veprimtaritë e tyre publike, në mënyrë të tillë për të marrë gjithë informacionin e duhur e për të gjykuar më pas kur është rasti mbi ndalimin e veprimtarisë.

Ndërfaqja e raportimeve është bërë e aksesueshme nga çdo person kontakti, më datë 13 Janar 2023.

Nga verifikimi i kryer nga Struktura Përgjegjëse në KQZ rezulton se më datë 13 Janar 2023, janë pajisur me kredencialet për krijimin e llogarive në ndërfaqe 510 Institucione, të cilat mund të aksesojnë ndërfaqen e raportimeve për të kryer raportimin e veprimtarive publike që do të zhvillonte institucioni i tyre.

Më datë 13 Janar 2023, filloi monitorimi i ndërfaqes së raportimeve, duke gjeneruar të dhëna nga ndërfaqja dhe duke i përditësuar ditë pas dite në databazën përkatëse, të krijuar për këtë qëllim.

Për periudhën nga data 13 Janar 2023 deri më datë 23 Janar 2023, rezulton si vijon:

- a. 524 institucione të regjistruara në ndërfaqen e raportimeve;
- b. 169 veprimtari të raportuara;
- c. 38 institucione raportuese;
- d. 25 institucione (nga 38) kanë respektuar afatin për raportim (jo më vonë se 5 (pesë) ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë publike;
- e. 2 institucione kanë raportuar për zhvillim veprimtarie publike, në kushtet e emergjencës për 7 (shtatë) veprimtari publike.

Problematikat e hasura:

Disa institucione kanë hasur vështirësi në aksesimin e ndërfaqes, duke ia bërë me dije Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Problematikat lidheshin kryesisht me pamundësinë për t'u loguar në ndërfaqen e raportimeve edhe pse në emailin e tyre ishin dërguar kredencialet nga ana e KQZ. Nga specialistët e IT problematika ka ardhur për shkak të kufizimeve të sigurisë kibernetike të vetë institucioneve.

Lista e disa prej institucioneve që hasën problematika në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Presidenti;
- Bashkia Elbasan;
- Prefektura Elbasan;
- Këshilli i Qarku Elbasan;
- Bashkia Fier;
- Bashkia Roskovec;
- Bashkia Himarë;
- Bashkia Tiranë;
- Prefektura Tiranë;
- Autoriteti Portual Durrës;
- Agjencia Shtetërore e Kadastrës;
- Autoriteti i Aviacionit Civil;
- Agjencia e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.

Gjetjet:

Institucionet raportuese në shkelje afati, për periudhën 13 - 19 Janar 2023

1. Kryeministria (1 rast);
2. Kuvendi (1 rast);
3. Minister i Shtetit për Marrëdhënien me Parlamentin (4 raste);
4. Ministria e Arsimit dhe Sportit (7 raste);
5. Ministria e Brendshme (1 rast);
6. Ministria e Kulturës (1 rast);
7. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (3 raste);
8. Autoriteti i Mediave Audiovizive (2 raste);
9. Bashkia Durrës (9 raste);
10. Bashkia Elbasan (2 raste);
11. Bashkia Gramsh (2 raste);
12. Bashkia Librazhd (2 raste);
13. Bashkia Roskovec (2 raste);
14. Bashkia Tiranë (12 raste);
15. Prefekti i Qarkut Lezhe (1 rast);
16. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (1 rast);
17. Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (1 rast);
18. Agjencia Shtetërore e Kadastrës (1 rast).

Institucionet raportuese në shkelje afati, për periudhën 20 - 23 Janar 2023

1. Minister i Shtetit për Rininë dhe Femijet (2 raste);
2. Ministria e Drejtësisë (1 rast);



3. Ministria e Kultures (3 raste);
4. Ministria E Turizmit (6 raste);
5. Autoriteti i Mediave Audiovizive (1 rast);
6. Drejtoria e Pergjithshme e sherbimeve te Transportit Rrugor (1 rast);
7. Prefekti i Qarkut Korçë (2 raste);
8. Bashkia Berat (2 raste);
9. Bashkia Dimal (1 rast);
10. Bashkia Durrës (2 raste);
11. Bashkia Elbasan (1 rast);
12. Bashkia Librazhd (1 rast);
13. Bashkia Lushnje (1 rast);
14. Bashkia Roskovec (2 raste);
15. Bashkia Tiranë (6 raste);
16. Ujësjiellës Kanalizime Cërrik (5 raste);
17. Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (1 rast);
18. Autoriteti Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë (1 rast);

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të kryejë procedurat e hetimit administrativ për sa është konstatuar më lart.

